Nr. Unik. 013/1
Data 8.3.2021
Deputet

**FORMULAR VETËDEKLARIMI**

**PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR. 138/2015 "PËR GARANTIMIN E INTEGRITETIT TË PERSONAVE QË ZGJIDHEN, EMËROHEN OSE USHTROJNË FUNKSIONE PUBLIKE"**

**DATË: 07 / 03 / 2021**

## I. TË DHËNAT PERSONALE

### A. Gjenealitetet aktuale

| | |
|---|---|
| **EMËR** | BOIKEN |
| **MBIEMËR** | ABAZI |
| **ATËSI** | XHELAL |
| **AMËSI** | VJOLLCA |
| **DATËLINDJE** | 28 / 04 / 1982 |
| **VENDLINDJE** | TIRANË |
| **VENDBANIM** | TIRANË |
| **NR. ID** | I20428079H |

### B. Gjenealitete të mëparshme

(Nëse keni ndryshuar zyrtarisht ndonjë nga të dhënat e gjeneralitetit tuaj, apo keni përdorur një gjeneralitet tjetër, qoftë edhe pa e ndryshuar zyrtarisht, listoni secilin prej tyre, duke plotësuar të gjitha të dhënat që janë ndryshuar dhe aq herë sa janë ndryshuar. *Mosdeklarimi i ndonjë gjeneraliteti sipas kësaj pike, që mund të pengojë verifikimin sipas dispozitave të ligjit nr. 138/2015, përbën vepër penale sipas nenit 190 të Kodit Penal.*)

| | |
|---|---|
| **EMËR** | |
| **MBIEMËR** | |
| **ATËSI** | |
| **AMËSI** | |
| **DATËLINDJE** | |
| **VENDLINDJE** | |

Boiken Abazi

(emër, mbiemër, nënshkrim)



Shqiptarja.com

## II. MARRJE DIJENI MBI EFEKTET E FORMULARIT TË VETËDEKLARIMIT

Unë, i/e nënshkruari /a BOIKEN ABAZI, kam marrë dijeni dhe jam i vetëdijshëm se:

**a) Ky Formular përbën dokument zyrtar që i drejtohet një organi shtetëror dhe i nënshtrohet verifikimit dhe publikimit.**

**b) Pasqyrimi i të dhënave të rreme në këtë Formular përbën vepër penale dhe dënohet me burgim sipas nenit 190 të Kodit Penal.**

**c) Të dhënat e pasqyruara në këtë Formular i nënshtrohen verifikimit të plotë, brenda dhe jashtë Shqipërisë, nga organet shtetërore dhe Prokuroria e Përgjithshme.**

**ç) Me plotësimin e këtij Formulari, kam dhënë pëlqimin për verifikimin e çdo të dhëne personale, përfshirë gjurmët daktiloskopike dhe çdo të dhënë tjetër biometrike.**

**d) Pasqyrimi i të dhënave të pavërteta, të paplota, dhe të pasakta në këtë Formular dhe refuzimi i depozitimit të gjurmëve daktiloskopike, passjell skualifikimin e menjëhershëm dhe në çdo kohë nga kandidimi/zgjedhja/emërimi apo ushtrimi i mëtejshëm i funksionit publik.**

**e) Trajtimi i të dhënave do të kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.**

Duke qenë i vetëdijshëm për pasojat ligjore në rast të deklarimeve të pavërteta, të paplota apo të pasakta, konfirmoj saktësinë e të dhënave të pasqyruara në këtë Formular.

***KUJDES*: JENI I/E SIGURT? SUGJEROHET QË NËNSHKRIMI I KËTIJ SEKSIONI TË BËHET PASI ËSHTË PLOTËSUAR SAKTË I GJITHË FORMULARI!**

Boiken Abazi [signature]

*(emër, mbiemër, nënshkrim)*

Boiken Abazi [signature]

(emër, mbiemër, nënshkrim)

[Shqiptarja.com]

## III. TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT

1. ***A jeni dënuar ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj?** (Vendos X përbri përgjigjes)*

PO [X] JO [ ]

- Nëse po, specifikoni të dhënat e mëposhtme:

| Të dhënat e vendimit gjyqësor | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Gjykata** | **Nr. dhe data e vendimit gjyqësor të formës së prerë** | **Masa e dënimit me burgim** | **Vepra penale për të cilën jeni dënuar** | |
| | | | **Neni** | **Lloji** |
| Siç kam shpjeguar edhe në formularin e parë të dorëzuar në KQZ në datën 26 shkurt 2021, nuk kam informacion zyrtar nga autoritetet e Kosovës në lidhje me Republikën e Kosovës (Për më shumë, referojuni sqarimit në fund të këtij formulari) edhe pse këtë gjë e kam kërkuar prej autoriteteve të Kosovës. Por i gjithë aktiviteti im ka qenë publik në Kosovë dhe i lidhur me organizimet politike të Lëvizjes VETËVENDOSJE!. Për shkak të shkresës së KQZ-së në Shqipëri, data 6 mars 2021, ku më kërkohet ta plotësoj këtë pjesë të formularit të dekriminalizimit pavarësisht mungesës së informacionit zyrtar nga autoritetet e Kosovës, atëherë në bazë të hulumtimit që kam bërë të raportimeve mediatike (https://kosovalb.com/2012/10/17/protesta-e-vv-emrat-e-62-te-arrestuarve/), memories time, dhe diskutimit me kolegët e Lëvizjes VETËVENDOSJE!, deklaroj se më 17 tetor 2012, janë ndaluar nga Policia e Kosovës 62 aktivistë të Lëvizjes VETËVENDOSJE! për shkak të pjesëmarrjes në organizimin politik të Lëvizjes VETËVENDOSJE! ku kundërshtohej nënshkrimi i marrëveshjes për privatizimin e Kompanisë Publike të Kosovës për Distribucionin për Furnizim me Energji Elektrike. Mes aktivistëve të ndaluar nga policia kam qenë edhe unë. Kam bindjen se shumica e aktivistëve të ndaluar janë proceduar nga "Gjykata Komunale për Kundërvajtje në Prishtinë" | Data: 17 tetor 2012<br><br>Nuk e kam numrin e vendimit për rastin tim. Por një nga vendimet që u mor atë ditë ndaj aktivistëve të Lëvizjes VETËVENDOSJE! nga Gjykata Komunale për Kundërvajtje në Prishtinë ka numrin e regjistrimit si në vijim: 46450/2012. Në bazë të këtij numri, autoritetet do mund të gjenin edhe numrin për ndonjë vendim të marrë ndaj meje në po atë ditë nga Gjykata Komunale për Kundërvajtje në Prishtinë. Nuk jam në dijeni që ekziston ndonjë tjetër lloj vendimi ndaj meje që lidhet me këtë rast. | Nuk ka patur masë dënimi me burg, dhe unë jam liruar brenda ditës. | Neni 16, Ligji mbi rendin dhe qetësinë publike në Republikën e Kosovës. | Kundërvajte - Gjobë në shumën 450 Euro. Në dijeninë time gjoba është paguar. |

Boiken Abazi [signature]

**(emër, mbiemër, nënshkrim)**

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Në këtë rast besoj se e njëjta gjykatë e sipërpërmendur ka proceduar edhe rastin tim bashkë me aktivistët e tjerë. | | | | |
| Nuk jam në dijeni për ndonjë tjetër rast dënimi nga gjykatat në shtetet ku kam jetuar apo që kam vizituar. E vetmja situatë e paqartë lidhet me Kosovën, për shkak të angazhimit tim politik me Lëvizjen VETËVENDOSJE! në Kosovë, dhe për shkak se autoritetet e Kosovës kanë refuzuar të më japin informacion zyrtar. Për më shumë, referojuni sqarimit në fund të këtij formulari. | Nuk më është dhënë informacion nga organet kompetente në Kosovë, edhe pse këtë gjë e kam kërkuar. Për më shumë, referojuni sqarimit në fund të këtij formulari. | Në dijeninë time nuk jam dënuar me burgim askund. Vizitoj Kosovën rregullisht, zyrtarisht dhe publikisht dhe nuk jam ndaluar nga policía për ndonjë masë dënimi me burg dhe nuk më është dhënë nga policía e Kosovës apo e një shteti tjetër informacion se jam dënuar ndonjë herë me burgim. Për më shumë, referojuni sqarimit në fund të këtij formulari. | Nuk më është dhënë informacion nga organet kompetente në Kosovë. Për më shumë, referojuni sqarimit në fund të këtij formulari. | Nuk më është dhënë informacion nga organet kompetente në Kosovë. Për më shumë, referojuni sqarimit në fund të këtij formulari. |

Shqiptarja.com

2. ***A jeni dënuar me burgim me vendim gjyqësor jopërfundimtar nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj, për një çështje penale të pazgjidhur me vendim gjyqësor të formës së prerë?*** *(Vendos X përbri përgjigjes)*

PO [ ] JO [X]

- Nëse po, specifikoni të dhënat e mëposhtme:

**Të dhënat e vendimit gjyqësor**

Boiken Abazi [signature]

**(emër, mbiemër, nënshkrim)**

| Të dhënat e vendimit gjyqësor jopërfundimtar | Gjykata | Vepra penale për të cilën jeni dënuar | | Vendimi përfundimtar/Dënimi |
|---|---|---|---|---|
| | | Neni | Lloji | |
| Në dijeninë time nuk jam dënuar me burg në asnjë shtet ku kam jetuar apo që kam vizituar. E vetmja situatë e paqartë lidhet me Kosovën, për shkak të angazhimit tim politik me Lëvizjen VETËVENDOSJE! në Kosovë, dhe për shkak se autoritetet e Kosovës kanë refuzuar të më japin informacion zyrtar. Megjithatë unë e vizitoj Kosovën rregullisht, publikisht dhe zyrtarisht, dhe nuk jam njoftuar nga organet kompetente për raste të tilla. Për më shumë, referojuni sqarimit në fund të këtij formulari. | Nuk më është dhënë informacion nga organet kompetente në Kosovë. Për më shumë, referojuni sqarimit në fund të këtij formulari. | Nuk më është dhënë informacion nga organet kompetente në Kosovë. Për më shumë, referojuni sqarimit në fund të këtij formulari. | Nuk më është dhënë informacion nga organet kompetente në Kosovë. Për më shumë, referojuni sqarimit në fund të këtij formulari. | Nuk më është dhënë informacion nga organet kompetente në Kosovë. Për më shumë, referojuni sqarimit në fund të këtij formulari. |

3. ***A keni qenë ndonjëherë në hetim ose gjykim nga një autoritet i huaj, për kryerjen e një vepre penale?** (Vendos X përbri përgjigjes)*

PO [X]    JO [ ]

- Nëse po, specifikoni të dhënat e mëposhtme:

| Organi procedues | Qyteti, Shteti | Arsyet | Periudha/Data | Rezultatet |
|---|---|---|---|---|
| Rastet për të cilat mund të kem qenë në hetim ose gjykim në një shtet tjetër jashtë Republikës së Shqipërisë lidhen vetëm me Republikën e Kosovës dhe pjesëmarrjen time në organizimet politike të Lëvizjes VETËVENDOSJE! | Prishtinë, Kosovë | Pjesëmarrja në organizimin e Lëvizjes VETËVENDOSJE! në Kosovë që kundërshtonte koncensionet e | 3 shtator 2011 | Bazuar mbi raportimet mediatike, memorien time dhe diskutimet me kolegët e Lëvizjes VETËVENDOSJE!, jam mbajtur në paraburgim rreth 48 orë, më tej jam liruar |

Boiken Abazi [signature]

**(emër, mbiemër, nënshkrim)**



shqiptarja.com

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| në Kosovë. Nuk më është dhënë informacion zyrtar nga organet kompetente në Kosovë lidhur me këtë çështje edhe pse këtë gjë e kam kërkuar zyrtarisht (Ju lutem t'i referoheni sqarimit në fund të këtij formulari). Për shkak të shkresës së KQZ-së në Shqipëri, data 6 mars 2021, ku më kërkohet ta plotësoj këtë pjesë të formularit të dekriminalizimit pavarësisht mungesës së informacionit zyrtar nga autoritetet e Kosovës, atëherë<br>në këtë pjesë të formularit të vetëdeklarimit unë do të përfshij shtatë (7) raste (përfshirë rastin e sqaruar më lart në seksionin III, pika 1, faqja 3 e këtij formulari) në rend kronologjik, në bazë të hulumtimit që kam bërë të raportimeve mediatike, kujtesës sime, dhe diskutimit me kolegët e Lëvizjes VETËVENDOSJE!. Ndërsa në lidhje me deportimin tim nga Kosova, më 16 mars 2016, krejt të motivuar politikisht, rasti është shpjeguar më poshtë, në pyetjen nr. 7 të këtij formulari.<br><br>Rasti i parë lidhet me organizimin politik të Lëvizjes VETËVENDOSJE! në Kosovë, të datës 3 shtator 2011, ku kundërshtoheshin koncensionet e vazhdueshme të Kosovës ndaj Serbisë në dialogun Kosovë- Serbi. Në këtë organizim politik të Lëvizjes VETËVENDOSJE! u ndalën nga policia 35 aktivistë (https://www.youtube.com/watch?v=Bnr4a_L0W2E&lc=UgyKy5nhwppqmN87c1d4AaABAg) të Lëvizjes VETËVENDOSJE!, mes tyre | | Kosovës ndaj Serbisë në dialogun Kosovë – Serbi. | | dhe nuk jam njoftuar më zyrtarisht për ecurinë e këtij rasti nga autoritetet e Republikës së Kosovës. |

[shqiptarja.com]

Boiken Abazi

(emër, mbiemër, nënshkrim)

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| edhe unë. Organet proceduese duhet të kenë qenë Policia dhe Prokuroria e Republikës së Kosovës. | | | | |
| Rasti i dytë lidhet me datën 14 janar 2012 dhe organizimin politik të Lëvizjes VETËVENDOSJE! të titulluar "Serbia nuk kalon", në mbështetje të zbatimit të masave të reciprocitetit të Kosovës ndaj Serbisë. Në këtë organizim u ndalën nga Policia e Kosovës 146 aktivistë dhe deputetë të Lëvizjes VETËVENDOSJE!, mes tyre edhe unë (https://www.evropaelire.org/a/24451918.html dhe http://www.panorama.com.al/vetevendosje-zbatoni-masat-ose-proteste-e-re-me-22-janar/ ). Organet proceduese duhet të kenë qenë Policia dhe Prokuroria e Republikës së Kosovës. | Dheu i Bardhë, Gjilan, Kosovë | Pjesëmarrja në organizimin e Lëvizjes VETËVENDOSJE! në mbështetje të zbatimit të masave të reciprocitetit të Kosovës ndaj Serbisë. | 14 janar 2012 | Bazuar mbi raportimet mediatike, memorien time dhe diskutimet me kolegët e Lëvizjes VETËVENDOSJE!, jam mbajtur në paraburgim rreth 48 orë në Gjilan, Kosovë, më tej jam liruar dhe nuk jam njoftuar më zyrtarisht për ecurinë e këtij rasti nga autoritetet e Republikës së Kosovës. |
| Rasti i tretë lidhet me datën 22 janar 2012 dhe organizimin politik të Lëvizjes VETËVENDOSJE! të titulluar sërish "Serbia nuk kalon" si vazhdimësi e organizimit të datës 14 janar 2012. Edhe më 22 janar 2012 organizimi ishte në mbështetje të zbatimit të masave të reciprocitetit të Kosovës ndaj Serbisë. Në këtë organizim u ndalën nga Policia e Kosovës 6 aktivistë të Lëvizjes VETËVENDOSJE!, qytetarë të Republikës së Shqipërisë, mes tyre edhe unë (http://www.panorama.com.al/vetevendosje-zbatoni-masat-ose-proteste-e-re-me-22-janar/ ). Organet proceduese duhet të kenë qenë Policia dhe Prokuroria e Republikës së Kosovës. | Pika Kufitare e Kosovës, mes Kosovës dhe Shqipërisë në Morinë. | Pjesëmarrja në organizimin e Lëvizjes VETËVENDOSJE! në mbështetje të zbatimit të masave të reciprocitetit të Kosovës ndaj Serbisë. Policia e Kosovës ndali në kufi, në mënyrë arbitrare dhe pa urdhërarrest, qytetarë të Republikës së Shqipërisë që ishin nisur në solidaritet për të marrë pjesë në organizimin e Lëvizjes | 22 janar 2012 | Bazuar mbi raportimet mediatike, kujtesës sime dhe diskutimet me kolegët e Lëvizjes VETËVENDOSJE!, jam mbajtur rreth 1-2 orë në paraburgim në Pikën Kufitare të Kosovës në Morinë. Më tej jam liruar dhe nuk jam njoftuar më zyrtarisht për ecurinë e këtij rasti nga autoritetet e Republikës së Kosovës. Pasi u lirova, Policia e Kosovës nuk ma ndali hyrjen në Republikën e Kosovës dhe bashkë me qytetarë të tjerë të Republikës së Shqipërisë iu bashkuam organizimit politik të Lëvizjes VETËVENDOSJE! në |

Boiken Abazi [signature] **(emër, mbiemër, nënshkrim)**

Lexoshqiptarja.com

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | VETËVENDO SJE! në Kosovë. | | Merdare, Kosovë, në mbështetje të zbatimit të masave të reciprocitetit ndaj Serbisë. |
| Rasti i katërt është shpjeguar edhe më lart në seksionin III, pika 1, faqja 3 e këtij formulari. Në bazë të hulumtimit që kam bërë të raportimeve mediatike (https://kosovalb.com/2012/10/17/protesta-e-vv-emrat-e-62-te-arrestuarve/), kujtesës sime, dhe diskutimit me kolegët e Lëvizjes VETËVENDOSJE!, deklaroj se më 17 tetor 2012, janë ndaluar nga Policia e Kosovës 62 aktivistë të Lëvizjes VETËVENDOSJE! për shkak të pjesëmarrjes në organizimin politik të Lëvizjes VETËVENDOSJE! ku kundërshtohej nënshkrimi i marrëveshjes për privatizimin e Kompanisë Publike të Kosovës për Distribucionin për Furnizim me Energji Elektrike. Mes aktivistëve të ndaluar nga policia kam qenë edhe unë. Kam bindjen se shumica e aktivistëve të ndaluar janë proceduar nga "Gjykata Komunale për Kundërvajtje në Prishtinë"<br><br>Në këtë rast besoj se e njëjta gjykatë e sipërpërmendur ka proceduar edhe rastin tim bashkë me aktivistët e tjerë. | Prishtinë, Kosovë | Neni 16, Ligji mbi rendin dhe qetësinë publike në Republikën e Kosovës. | 17 tetor 2012 | Kundërvajtje - Gjobë në shumën 450 Euro. Në dijeninë time gjoba është paguar, por jo nga unë. |
| Rasti i pestë lidhet me organizimin politik të Lëvizjes VETËVENDOSJE! në Prishtinë, Kosovë, për të kundërshtuar koncesionet e Kosovës ndaj Serbisë në dialogun Kosovë – Serbi. Të paktën 33 aktivistë të Lëvizjes VETËVENDOSJE! janë ndaluar nga Policia e Kosovës | Prishtinë, Kosovë | Pjesëmarrja në organizimin e Lëvizjes VETËVENDO SJE! në kundërshtim të koncesioneve të Kosovës ndaj Serbisë në dialogun | 22 tetor 2012 | Bazuar mbi raportimet mediatike, kujtesës sime dhe diskutimet me kolegët e Lëvizjes VETËVENDOSJE!, jam mbajtur në paraburgim rreth 48 orë në Kosovë, më tej jam liruar dhe nuk jam njoftuar më zyrtarisht për ecurinë e këtij |

Boiken Abazi [signature]

**(emër, mbiemër, nënshkrim)**



shqiptarja.com

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| në këtë organizim (http://www.albaniapress.com/lajme/17100/Sot-proteste-kunder-dhunes-qeveritare-dhe-brutalitetit-policor.html dhe http://www.gazetatema.net/2012/10/22/policia-dhune-brutale-mbi-vetvendosjen-riorganizohet-protesta-drejt-qeverise/), mes tyre edhe unë. Organet proceduese duhet të kenë qenë Policia dhe Prokuroria e Republikës së Kosovës. | | Kosovë – Serbi. . | | rasti nga autoritetet e Republikës së Kosovës. Në dijeninë time, për këtë rast Lëvizja VETËVENDOSJE! ka dorëzuar edhe kallëzim penal kundër Policisë së Kosovës, për keqtrajtimin e qytetarëve gjatë organizimit politik dhe brenda komisariateve të policisë. |
| Rasti i gjashtë, lidhet me datën 12 tetor 2015, rreth orës 21:05, në afërsi të Prishtinës ku është ndalur vetura e markës "Passat" me targa 01-917-HG. Në këtë veturë gjendej Albin Kurti, deputet i Kuvendit të Kosovës, unë, Boiken Abazi, Sekretar për Marrëdhënie me Jashtë, Veton Dragusha, aktivist dhe Glauk Konjufca, deputet i Kuvendit të Kosovës. Atë natë (12 tetor 2015) ne jemi ndalur nga zyrtarët e Policisë së Kosovë në afërsi të Prishtinës, të cilët na kanë nxjerrë në mënyrë të dhunshme nga automjeti, na kanë vendosur në pranga, dhe, më tej, në pranga, na kanë shoqëruar për në komisariat në mënyrë të kundërligjshme, në formë rrëmbimi, pa urdhër arrest të Prokurorisë Themelore në Prishtinë (**https://www.botasot.info/lajme/469346/kurti-ushtron-kallezim-penal-ndaj-policeve-qe-e-arrestuan/**).<br><br>Organet proceduese duhet të kenë qenë Policia dhe Prokuroria e Republikës së Kosovës. | Prishtinë, Kosovë | E vetmja arsye pse mund të jem ndalur nga Policia e Kosovës atë ditë është fakti se isha duke udhëtuar në të njëjtin automjet me të cilin po udhëtonte edhe deputeti Albin Kurti. | 12 tetor 2012 | Bazuar mbi raportimet mediatike, memorien time dhe diskutimet me kolegët e Lëvizjes VETËVENDOSJE!, jam mbajtur në paraburgim rreth 3 orë në Prishtinë. Më tej jam liruar dhe nuk jam njoftuar më zyrtarisht për ecurinë e këtij rasti nga autoritetet e Republikës së Kosovës. Në dijeninë time, për këtë rast deputeti Albin Kurti ka dorëzuar edhe kallëzim penal kundër Policisë së Kosovës, për keqtrajtimin e personave të ndaluar atë ditë. |

Boiken Abazi

**(emër, mbiemër, nënshkrim)**



Shqiptarja.com

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Rasti i shtatë lidhet me organizimin politik të Lëvizjes VETËVENDOSJE! në kundërshtim të deklaratave të ministrit serb Aleksandar Jabllanoviç, që i pati cilësuar si "egërsira" familjarët e personave të zhdukur në Gjakovë. Organizimi u zhvillua para selisë së Ministrisë për Kthim dhe Komunitete, në komunën e Fushë Kosovës, dhe u kërkuar shkarkimi i ministrit Jabllanoviç. Në këtë organizim politik Policia ndali 19 aktivistë të Lëvizjes VETËVENDOSJE! (https://top-channel.tv/2015/01/16/protesta-kunder-keds-dhe-jabllanovic-perleshje-me-policine/), mes tyre edhe mua.<br><br>Organet proceduese duhet të kenë qenë Policia dhe Prokuroria e Republikës së Kosovës. | Fushë Kosovë, Kosovë | Pjesëmarrja ime në organizimin politik të Lëvizjes VETËVENDOSJE! në kundërshtim të deklaratave të ministrit serb Aleksandar Jabllanoviç, që i pati cilësuar si "egërsira" familjarët e personave të zhdukur në Gjakovë. | 16 janar 2015 | Bazuar mbi raportimet mediatike, kujtesës sime dhe diskutimet me kolegët e Lëvizjes VETËVENDOSJE!, jam mbajtur në paraburgim rreth 5 orë në komunën e Fushë Kosovës. Më tej jam liruar dhe nuk jam njoftuar më zyrtarisht për ecurinë e këtij rasti nga autoritetet e Republikës së Kosovës. |

4. ***A keni qenë ndonjëherë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligjzbatuese, për kryerjen e një vepre penale?** (Vendos X përbri përgjigjes)*

PO [X] JO [ ]

- Nëse po, specifikoni të dhënat e mëposhtme:

| Organi procedues | Qyteti, Shteti | Arsyet | Periudha/Data | Rezultatet |
|---|---|---|---|---|
| Policia e Shtetit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë. | Tiranë, Shqipëri | Akuzat e ngritura ndaj meje lidheshin me dyshimin për kryerjen e këtyre veprave: "Kundërshtim i punonjësit të policisë së rendit | 17 – 20 maj 2020 | Pushimi i të gjitha akuzave dhe shuarja e masës së sigurimit "Detyrim për t'u paraqitur në policinë gjyqësore" në seancën gjyqësore të mbajtur më 25 janar 2021. |

Boiken Abazi [signature]
**(emër, mbiemër, nënshkrim)**



[Shqiptarja.com]

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | publik", "Organizim dhe pjesëmarrja në grumbullim e manifestime të paligjshme", pengimi i qarkullimit të mjeteve të transportit".<br><br>Të gjitha këto akuza lidheshin me pjesëmarrjen time në protestën paqësore të datës 17 maj 2020 ku kisha dalë bashkë me qytetarë të tjerë në mbrotje të Teatrit Kombëtar në Tiranë, Monument Kulture, i cili u shemb nga autoritetet në shkelje të ligjit, dhe për këtë shkelje janë hapur raste gjyqësore ndaj autoriteteve të Republikës së Shqipërisë. | | |
| Policia e Shtetit | Tiranë, Shqipëri | Jam ndalur nga Policia e Shtetit duke ecur në rrugë, në drejtim të protestës qytetare paqësore që po mbahej para Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme në kundështim të marrëdhënieve jo reciproke mes | 20 tetor 2020 | Pasi jam shoqëruar në Komisariat, jam liruar po atë ditë (20 tetor 2020) nga komisariati brenda 5 orëve. Nga gjithë informacioni që disponoj nuk di të jem në hetime, dhe nuk jam në dijeni nëse janë ngritur akuza ndaj meje në lidhje me këtë rast. |

Boiken Abazi

(emër, mbiemër, nënshkrim)



[shqiptarja.com]

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | Shqipërisë dhe Greqisë, dhe koncensioneve të Shqipërisë ndaj Greqisë, duke përfshirë çështjen e Detit Jon, çështjen e shqiptarëve të Çamërisë, etj. Jam shoqëruar më tej, pa më dhënë asnjë shpjegim, tek komisariati nr. 4 në Tiranë. | | |
| Rastet që lidhen me angazhimin tim politik në Kosovë me Lëvizjen VETËVENDOSJE! janë shpjeguar më lart në këtë formular në përgjigjet e dhëna nga unë për Pyetjen nr. 3. | | | | |

5. ***A është caktuar ndaj jush ndonjëherë masë shtrënguese e sigurisë personale, në fuqi ose jo? (Vendos X përbri përgjigjes)***

PO [X] JO [ ]

- Nëse po, specifikoni të dhënat e mëposhtme:

| MASAT SHTRËNGUESE TË SIGURISË | PËRGJIGJE | |
|---|---|---|
| | *Aktualisht në fuqi* | *E revokuar* |
| Ndalimi i daljes jashtë shtetit | ☐ | ☐ |
| Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore | ☐ | ☒ |
| Ndalimi dhe detyrimi i qëndrimit në një vend të caktuar | ☐ | ☐ |
| Garancia pasurore | ☐ | ☐ |
| Arresti në shtëpi | ☐ | ☐ |
| Arresti në burg | ☐ | ☐ |
| Shtrimi i përkohshëm në një spital psikiatrik | ☐ | ☐ |

- Nëse po, specifikoni të dhënat e mëposhtme:

| Gjykata | Qyteti, shteti | Vepra penale për të cilën akuzoheshit | | Vendimi përfundimtar | Periudha, data |
|---|---|---|---|---|---|
| | | Neni | Lloji | | |
| Gjykata e Rrethit | Tiranë, Shqipëri | 234 i K. Pr. Penale, | "Kundërshtim i punonjësit të policisë së | Pushimi i të gjitha akuzave dhe shuarja e masës së sigurimit | 20.05.2019 deri më 25.01.2021 |

Boiken Abazi [nënshkrim]

**(emër, mbiemër, nënshkrim)**



[kryeartikulli.com]

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Gjyqësor Tiranë | | 262/2 dhe 236/2 i K. Penal | rendit publik", "Organizim dhe pjesëmarrja në grumbullim e manifestime të paligjshme", pengimi i qarkullimit të mjeteve të transportit".<br><br>Të gjitha këto akuza lidheshin me pjesëmarrjen time në protestën paqësore të datës 17 maj 2020 ku kisha dalë bashkë me qytetarë të tjerë në mbrojtje të Teatrit Kombëtar në Tiranë, Monument Kulture, i cili u shemb nga autoritetet në shkelje të ligjit. | "Detyrim për t'u paraqitur në policinë gjyqësore" në seancën gjyqësore të mbajtur më 25 janar 2021. | |
| Nuk më është dhënë informacion nga organet kompetente në Kosovë edhe pse këtë gjë e kam kërkuar zyrtarisht. Ju lutem t'i referoheni sqarimit në fund të këtij formulari. | Nuk më është dhënë informacion nga organet kompetente në Prishtinë, Kosovë, edhe pse këtë gjë e kam kërkuar zyrtarisht. Ju lutem t'i referoheni sqarimit në fund të këtij formulari. | Nuk më është dhënë informacion nga organet kompetente në Kosovë edhe pse këtë gjë e kam kërkuar zyrtarisht. Ju lutem t'i referoheni sqarimit në fund të këtij formulari. | Nuk më është dhënë informacion nga organet kompetente në Kosovë edhe pse këtë gjë e kam kërkuar zyrtarisht. Ju lutem t'i referoheni sqarimit në fund të këtij formulari. | Nuk më është dhënë informacion nga organet kompetente në Kosovë edhe pse këtë gjë e kam kërkuar zyrtarisht. Ju lutem t'i referoheni sqarimit në fund të këtij formulari. | Nuk më është dhënë informacion nga organet kompetente në Kosovë edhe pse këtë gjë e kam kërkuar zyrtarisht. Ju lutem t'i referoheni sqarimit në fund të këtij formulari. |

Boiken Abazi

**(emër, mbiemër, nënshkrim)**



[shqiptarja.com]

6. ***A është lëshuar ndonjëherë ndaj personit tuaj një urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e veprave penale?*** *(Vendos X përbri përgjigjes)*

PO [ ] JO [X]

Nëse po, specifikoni të dhënat e mëposhtme:

| Autoriteti urdhërues | Arsyeja | Qyteti, Shteti | Ekzekutimi (nëse është në fuqi apo jo) |
|---|---|---|---|
| | | | |
| | | | |
| | | | |

7. ***A është marrë ndonjëherë për ju masa e dëbimit nga një shtet i huaj?***
*(Me përjashtim të rastit kur jeni dëbuar ekskluzivisht për shkeljen e rregullave të emigracionit që kanë të bëjnë me rregullat e qëndrimit apo hyrje-daljes në një territor të një shteti të huaj) (Vendos X përbri përgjigjes)*

PO [X] JO [ ]

- Nëse po, specifikoni të dhënat e mëposhtme:

| Qyteti dhe Shteti ku keni jetuar | Arsyeja dëbimit | Periudha e dëbimit nga shteti i huaj | Të dhanat e aktit të dëbimit |
|---|---|---|---|
| Prishtinë, Kosovë | Masa ndaj meje ka qenë krejtësisht e motivuar politikisht nga organet e kapura të shtetit të Kosovës. Në masën për dëbimin tim me forcë nga Kosova, të aktivizuar më 16 mars 2016, shkruhet se isha i ngarkuar me 5 vepra penale nga autoritetet e Kosovës. Mirëpo, po të isha në hetim për 5 vepra penale, atëherë do duheshin çuar në hetim për vepër penale zyrtarët që me kanë debuar nga Kosova. Po të isha në hetim për vepra penale, atëherë do duhej të më çonin në gjykatë e jo të më dëbonin nga Kosova. Fakti që dëshmon se nuk kam patur vepra penale dhe se kjo masë ka qenë krejtësisht e motivuar | 16 mars 2016 deri më 16 mars 2018 (2 vite ndalesë për hyrje)<br><br>Pas datës 16 mars 2018, kam hyrë e kam dalë nga Republika e Kosovës pa asnjë problem, zyrtarisht dhe publikisht, dhe kam vazhduar i lirë aktivitetin tim politik publik me Lëvizjen VETËVENDOSJE! në Kosovë. | Ministria e Punëve të Brendshme Drejtoria për Migrim dhe të Huaj në Policinë e Kosovës<br>Nr. Reference: 011/2016 |

Boiken Abazi [signature]

**(emër, mbiemër, nënshkrim)**



[Shqiptarja.com]

| | | | |
|---|---|---|---|
| | politikisht, është deklarata zyrtare dhe publike e dhënë për mediat në datën 17 mars 2016 nga zëdhënësi i Policisë së Kosovës, Baki Kelani, i cili ka deklaruar se "I njëjti (Boiken Abazi v.j.) është larguar se ka kundërvajtje, e jo vepër penale. Aty në njëfarë mënyrë është një gabim teknik i përvjedhur. Ndryshe, ai nuk ka vepër penale por vetëm kundërvajtje".<br><br>Marrë nga: https://insajderi.com/policia-gabuam-me-boiken-abazin-nuk-ka-kryer-asnje-veper-penale/<br><br>Për më tepër, para këtij dëbimi nuk kam qenë kurrë i njoftuar as me shkrim dhe as me gojë nga Policia e Kosovës për pretendimet e ngritura ndaj meje në masën e dëbimit me forcë nga Kosova. Vetë zyrtari i autoriteteve të Kosovës që ka nënshkruar masën e dëbimit ndaj meje nuk ka vendosur as emrin e tij në dokumentin e masës të ndërmarrë ndaj meje, vetëm nënshkrimin, dhe identiteti i tij mbetet sot e kësaj dite i pavërtetuar.<br><br>Bazuar mbi këto deklarata të policisë (referojuni edhe sqarimit në fund të këtij formulari) deri më sot unë nuk kam asnjë dëshmi që tregon se jam në hetim apo se jam dënuar ndonjë herë për vepra penale në Kosovë sipas asaj që shkruhet në urdhërin e deportimit tim me forcë nga Kosovë. Kini parasysh që atë ditë, pasi jam ndalur nga 3 civilë që më kanë shoqëruar për në Polici, unë nuk jam lejuar të kontaktoja me një avokat, as me Ambasadën e Republikës së Shqipërisë. Thjesht jam dërguar me një makinë të Policisë së Kosovës në zonën neutrale | | |

Boiken Abazi [signature]

**(emër, mbiemër, nënshkrim)**



[Shqiptarja.com]

| | | | |
|---|---|---|---|
| | mes kufirit Kosovë-Shqipëri në Morinë, pa i lajmëruar autoritetet e Republikës së Shqipërisë. Për më shumë, ju lutem t'i referoheni sqarimit në fund të këtij formulari. | | |

***<u>8. A keni jetuar ndonjëherë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për më shumë se 1 muaj?</u>*** *<u>(Vendos X përbri përgjigjes)</u>*

PO [X] JO [ ]

- Nëse po, specifikoni të dhënat e mëposhtme:

| Qyteti dhe Shteti ku keni jetuar | Arsyeja | Periudha | Adresa e vendqendrimit |
|---|---|---|---|
| Selanik, Greqi | Shkollim fillor (Klasa 6 – 8) | 1993 – 1996 | Kampusi i Kolegjit Anatolia Pinewood Schools of Thessaloniki Selanik, Greqi |
| Green Forest, Arkansas, SHBA | Shkollim (Viti IV - Gjimnaz) Program shkëmbimi | 1999 – 2000 | Familja Kupfersberger Green Forest, Arkansas, 72638 USA |
| Ypsilanti, Michigan, SHBA | Studimet Universitare | 2000 – 2004 | "Eastern Michigan University" Ypsilanti, Michigan, 48197 USA |
| New York, New York SHBA | Praktika e Punës | 2004 – 2005 | Association for World Travel Exchange 88 Street, New York New York, USA |
| Prishtinë, Kosovë Tiranë, Shqipëri | Angazhim politik me Lëvizjen VETËVENDOSJE! në Kosovë duke lëvizur vajtje – ardhje mes Shqipërisë dhe Kosovës | 2010 – 2016 | Lëvizja VETËVENDOSJE! Rr. Behije Dashi, Nr. 31, Prishtinë, Kosovë |
| Prishtinë, Kosovë Tiranë, Shqipëri | Angazhim politik me Lëvizjen VETËVENDOSJE! në Kosovë duke lëvizur vajtje – ardhje mes Shqipërisë dhe Kosovës | 2018 - 2019 | Lëvizja VETËVENDOSJE! Rr. Behije Dashi, Nr. 31, Prishtinë, Kosovë |

Duke qenë i vetëdijshëm për pasojat ligjore në rast të deklarimeve të pavërteta, të paplota apo të pasakta, konfirmoj saktësinë e të dhënave të pasqyruara në këtë Formular.

Boiken Abazi [signature]

*<u>(emër, mbiemër, nënshkrim)</u>*

Boiken Abazi [signature]

**(emër, mbiemër, nënshkrim)**

[Shqiptarja.com]

*Shënim: Në rast referimi të akteve, vendimeve dhe dokumenteve të caktuara, bashkëngjitini një kopje të tyre këtij Formulari.*

*Nëse pjesë të caktuara të Formularit janë të pamjaftueshme për deklarimin e të dhënave, shto aq pjesë sa ju nevojiten për pasqyrimin e të gjitha të dhënave.*

***Sqarim në lidhje me çështjet që i takojnë angazhimit tim politik në Republikën e Kosovës me Lëvizjen VETËVENDOSJE! gjatë periudhës 2011 – 2016***

*Autoritetet e Republikës së Kosovës kanë refuzuar të lëshojnë një dëshmi penaliteti në rastin tim me argumentin se kjo dëshmi nuk lëshohet për shtetas të huaj që nuk e kanë nënshtetësinë e Kosovës, apo që nuk kanë lejen e qendrimit (rezidencën) në Kosovë. Së paku në dy raste të ndryshme kjo kërkesë është shtruar ndaj autoriteteve të Kosovës, dhe është refuzuar, si në vijim:*

***Rasti 1:***

*28 janar 2021, Berat Ganiqi, Zyrtar Ligjor i Lëvizjes VETËVENDOSJE! në Kosovë, në cilësinë e përfaqesuesit tim ligjor, i autorizuar nga unë për të vepruar në emrin tim pranë autoriteteve të Republikës së Kosovës, ka aplikuar në internet, për shkak të masave të ndërmarra nga shteti i Kosovës në lidhje me pandeminë Covid-19, në platformën "on-line" të Gjykatës Themelore në Prishtinë, në adresën zyrtare: prishtine.gjyqesori-rks.org në seksionin "Kërkesa për Lëshimin e Çertifikatave" për të marrë një dëshmi penaliteti në përputhje me legjislacionin dhe rregullat në fuqi të Republikës së Kosovës. Ai nuk ka marrë asnjë përgjigje me shkrim në lidhje me këtë kërkesë. Z. Ganiqi është paraqitur fizikisht në Gjykatën Themelore në Prishtinë për këtë çështje në dy raste, në datën 2 dhe 3 shkurt 2021, dhe sërish i është refuzuar kërkesa me argumentin se dëshmi të tilla nuk lëshohen për rastin tim nga që nuk jam shtetas i Kosovës dhe nuk kam leje qëndrimi në Kosovë.*

***Rasti 2***

*Në datën 9 shkurt 2021, znj. Albulena Haxhiu, ish Ministre e Drejtesisë në Republikën e Kosovës, në cilësinë e anëtares së Kryesisë së Lëvizjes VETËVENDOSJE! është paraqitur fizikisht në Gjykatën Themelore në Prishtinë për të marrë një vërtetim në lidhje me dëshminë time të penalitetit, dhe autoritetet ia kanë refuzuar sërish kërkesën pa i kthyer një përgjigje zyrtare me argumentin se dëshmi të tilla nuk lëshohen për rastin tim nga që nuk jam shtetas i Kosovës dhe nuk kam leje qëndrimi në Kosovë.*

[shqiptarja.com]

Boiken Abazi

**(emër, mbiemër, nënshkrim)**